


ËSHTË MË SHUMË
SE INSTITUCION,



ËSHTË SHTËPIA
JONË

DËSHIRAT E NJË QYTETARI

NINA (11), DEAR (10), ENEA (10), GENISA (11), DION (10)



Qytetarët kanë dëshira të ndryshme që gjithmonë duan t'i realizojnë. E në demokraci, realizimi i dëshirave është më i mundshëm, sepse ka liri dhe barazi

Demokracia është sistem i qeverisjes, i cili na ka mundësuar të drejtat tona. Pa demokraci, jeta jonë nuk do të ishte shumë e lehtë. Ne do të ishim të diskriminuar, ngase nuk do të mbizotëronte barazia mes njerëzve. Andaj, ne e vlerësojmë dhe e çmojmë këtë



Shiko një të ardhme të ndritur me syzet e një qytetari demokratik

sistem, dhe jemi në gjendje të shkruajmë për të jo vetëm një gazetë, por edhe një libër nëse është nevoja. Sepse të flasësh për të drejtat e tua, të flasësh për rëndësinë e lirisë, paqes, shprehjes së lirë, tolerancës, solidaritetit, respektit nuk është çdo herë e mjaftueshme. E sa më shumë shkrime që ka, aq më shumë qytetarët vetëdijësohen dhe niveli i demokracisë rritet. Gjatë tërë rrugës nga Peja e deri në Prishtinë ne kemi

lexuar shkrime të ndryshme online për demokracinë dhe rëndësinë e saj në jetën tonë. E paramendojeni ndikimin e artikullit tonë në jetën e qytetarëve që do ta kenë në dorë! Për këtë, ne duam të ndikojmë gjithmonë në rritjen e nivelit të demokracisë. Por, asnjëherë nuk do të harrojmë të jemi sa më të lexueshëm, sepse informimi i qytetarëve mbetet ende çelësi i suksesit. Kjo njëkohësisht mbetet edhe dëshira jonë më e theksuar, derisa të ketë vetëdijësim të plotë për rolin, zhvillimin dhe ndikimin e demokracisë. Sikurse ne që kemi pasur nevojë që dikush të kujdeset për ne, të na ushqej, të na veshmbath, ashtu edhe demokracia ka nevojë për ta ruajtur, mbajtur dhe rritur. E ne jemi ata të cilët do të bëjmë një gjë të tillë, në bashkëpunim me të gjithë qytetarët e tjerë aktiv që duan dhe që kanë vullnet për të ndikuar për të mirë në vend. Jemi dhe gjithmonë do të mbesim shembull i denjë i qytetarëve demokratikë. Gjithmonë do të ftojmë në mirëkuptim.



Demokratët simpatikë

AKTIV SI NE

LEA (11), LIRI (10), VESA (10), DION (11), LORENA (11)

Me shokët dhe shoqet e klasës sot e kuptuam se ne kemi kryer veprime ndër vite që na bëjnë neve të kosiderohemi qytetarë aktiv. Por, a e dini ju se pse ne e quajmë veten qytetarë aktiv?


Ne quhemi qytetarë aktiv, sepse ne kontribuojmë për vendin tonë në mënyra të ndryshme. Këtë kontribut e kemi dhënë qysh nga koha kur jemi bërë të vetëdijshëm se ne kemi ndikim të fuqishëm në shtetin tonë. Nëse kemi cekur se jemi qytetarë aktiv, kjo nënkupton se ne: iu kemi ndihmuar të tjerëve, kemi pastruar ambiente të ndryshme, kemi marrë pjesë në OJQ, prindërit tanë kanë votuar dhe ne do të vazhdojmë të ndjekim këtë veprim, kemi organizuar programe të ndryshme edukative, nuk ia kemi mohuar askujt të drejtën e shprehjes, si dhe kemi respektuar dhe respektojmë gjithmonë ligjet e miratuara nga përfaqësuesit e popullit. Për më tepër, shikoni vizatimet tona si qytetarë aktiv.




Aktivizimi na dallon




Bota ka nevojë për qytetar aktiv, andaj bashkoi edhe ti



Disa nga elementet që e bëjnë një qytetar aktiv



A e ke ditur që edhe ti e gëzon këtë të drejtë?



Aktiv të dua edhe ty, i dashur lexues

RËNDËSIA E ZGJEDHJEVE

ARB (10), REA (10), LIBURNA (11), TAULANT (11), RRONI (11), ERDA (10)



Përshëndetje për të gjithë juve. Ne në këtë artikull do të shkruajmë për temën e zgjedhjeve. Shpresojmë që do t'iu pëlqej

Ne grupi ynë sot kemi mësuar për zgjedhjet. Zgjedhjet në Kosovë ndahen në dy lloje në zgjedhjet komunale (lokale) dhe zgjedhjet parlamentare (qendrore). Në zgjedhjet komunale ose lokale votojnë vetëm qytetarët e atij qyteti dhe fshatrat përreth. Këto vendbanime e përbëjnë një komunë. Të gjithë qytetarët duhet të votojnë në komunën e tyre përkatëse dhe jo për ndonjë komunë tjetër. Në zgjedhjet komunale votohen kryetari i komunës dhe asamblistët.

Zgjedhjet komunale rregullohen nga KKZ, i cili është Komisioni Komunal i Zgjedhjeve.

Tani do të flasim për zgjedhjet parlamentare ose qendrore. Në zgjedhjet parlamentare votohen deputetët e Kuvendit të Kosovës, nga qytetarët e shtetit të

Kosovës. Çdo qytetar ka të drejtën të votoj për kandidatin e preferuar. Ndërsa, këto zgjedhje rregullohen nga KQZ, apo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Përmes votave në procesin zgjedhor, qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre të cilët do ta udhëheqin vendin për 4 vjet. Rëndësia e votës është shumë e madhe, sepse vetëm një votë mund të bëj ndryshim. Të drejtën e votës e gëzojnë të gjithë qytetarët, që nga mosha 18 vjeçare, pa dallim moshe, feje, gjinie, etnie, etj. Së pari, duhet të mendojmë mirë para se ta fusim votën në kuti, sepse atë nuk mund ta tërheqim prapa. Së dyti, duhet të jemi të vendosur në vendimet tona dhe të mos ndikohemi nga mendimet e të tjerëve. Ne gjithmonë duhet të votojmë dhe këtë e kemi obligim, sepse kështu ndihmojmë popullin dhe veten tonë.

Tema e zgjedhjeve na pëlqeu shumë pasi që ne prej saj edhe mësuam shumë. Faleminderit për vëmendje!



Ne jemi gazetarët e këtij artikulli



Do t'i përfaqësoj interesat tuaja denjësisht

MEDIA E SHKRUAR DHE AJO ELEKTRONIKE

LITA (11), ENGJI (10), NORIK (10), KEON (10), VESA (10)

Ne jemi grupi i gazetarëve të cilët kemi diskutuar për median. Kjo temë na pëlqeu aq shumë sa që vendosëm të shkruajmë për të. Ju dëshirojmë lexim të këndshëm

Fillimisht media është burim i informacionit. Ajo ndahet në dy lloje: media e shkruar dhe media elektronike. Në mediat elektronike bëjnë pjesë: kompjuteri, radio, telefoni, portalet, etj. Kurse, në media të shkruara bëjnë pjesë: libri, revistat, tekstet, gazetatat, etj. Media shërben për të marrë informacione rreth tërë botës. Pa media ne nuk do të ishim kaq të informuar sa jemi tani. Kjo do të thotë se nëse ajo nuk do të ekzistonte ne do të ishim në një errësirë të plotë.


Gazetarët duhet të tregojnë informacione reale, të vërteta dhe të besueshme. Puna e tyre është shumë e rëndësishme. Se sa është e rëndësishme është në të vërtetë do të na tregoj shoqja jonë Engji.

Unë jam Engji Demaj dhe jam 18 vjeçare. Tani ka ardhur koha që unë të votoj, por unë nuk di shumë në lidhje me votimet. Prandaj, unë duhet të shikoj më shumë TV dhe duhet të lexoj më shumë gazeta në lidhje me zgjedhjet. Pas një muaji, erdhi koha të shkoj për të votuar. Tani unë di kë të votoj dhe nuk kam asnjë problem. Pra, unë kuptova se media është shumë e rëndësishme, për shkak se prej saj mora informata të vlefshme dhe më të hollësishme, të cilat do të më shërbejnë në jetën time të përditshme.


Faleminderit për vëmendjen tuaj, shpresojmë që ju kemi pëlqyer si gazetarë dhe se informatat e shënuara nga ne do t'iu hyjnë në punë ndonjë ditë.



Unë dhe shoku im për t'u informuar më shumë rreth zgjedhjeve shikuam një fushatë rreth zgjedhjeve



Por, nuk më mjaftuan vetëm ato informata. Prandaj, vendosa edhe të lexoj disa gazeta informuese



Pra, unë përdora të dy llojet e medias



Dhe në fund të gjithë i kuptuam ato

KUVENDI, SHTËPIA JONË

DEA (10), OLSA (10), LUM GJ. (10), ERIS (11), LORIK (10), ELION (11), ERON (10)




Kuvendi është institucioni i cili mbrohet dhe përfaqëson të gjithë qytetarët e vendit tonë

Fëmijët flasin për „Shtëpinë e Popullit“. Edhe ti i dashur lexues je pjesë e tij!

Të dashur lexues, ne nxënësit e klasës së V-të kishim kënaqësinë të shkruajmë rreth temave që kishin të bëjnë me demokracinë. Dy prej temave që grupi ynë i diskutoi ishin: Kuvendi dhe Deputetët.

Ne u munduam që të paraqesim në mënyrën më të mirë të mundshme rëndësinë e Kuvendit, por po ashtu



edhe të deputetëve. Në pjesën e parë të artikullit kemi shkruajtur për Kuvendin, kurse në pjesën e dytë për deputetët. Për Kuvendin filluam nga pyetja më e thjeshtë. Çka është Kuvendi dhe cili është roli i tij në jetën tonë? Kuvendi është i vetmi institucion ligjvënës në vend. Kjo do të thotë se Kuvendi nxjerr ligje. Rëndësia e tij në jetën tonë nënkuptohet nga kjo për shkak se ne funksionojmë në bazë të ligjeve që Kuvendi i miraton. Pothuajse e tërë jeta jonë mbështetet në ligjet që janë miratuar në Kuvend. Zakonisht ne si nxënës më shumë

i duam ligjet që kanë të bëjnë direkt me neve. Disa nga ato janë: arsimi fillor dhe i mesëm i ulët i obliguar, ku përmes tij sigurohet edhe marrja e librave falas deri në klasën e XI-të. Kjo na ndihmon neve si shoqëri, sepse jo të gjithë nga ne i kemi kushtet e mira ekonomike që t'i sigurojmë librat.

Tani do të flasim pak edhe për disa fakte rreth Kuvendit. Ky institucion ka disa funksione, por më të rëndësishmet janë: funksioni kontrollues, përfaqësues, dhe ai ligjvënës. Për rëndësinë e ligjeve veçse folëm më herët, kurse për funksionin përfaqësues do të informoheni në faqen tjetër. Të flasim tani për funksionin kontrollues. Kuvendi e kontrollon punën që e bën Qeveria, sepse Qeveria zgjedhet nga Kuvendi. Janë 120 deputetë të cilët janë në krye të këtyre funksioneve. E që të gjithë janë të zgjedhur me vota të lira të qytetarëve.




Puna në grup të vogël

LIS (10), BIJONA (11), LUMI Z. (10), EJA (11)

Nuk mund të flasim për Kuvendin, pa treguar pak edhe për deputetët si përfaqësues të popullit. Cili është roli i tyre dhe pse është e rëndësishme që të bëhet zgjedhja e drejtë e tyre? Për këto e disa pyetje të tjera, do të gjeni përgjigje në artikullin tonë

Deputetët në demokraci njihen si përfaqësues të popullit. Ata zgjedhen me vota të lira të qytetarëve. Për këtë arsye deputetëve iu referohemi si zëri i popullit. Roli i deputetëve është jashtëzakonisht i rëndësishëm në vendin tonë. Falë punës së palodhshme të tyre, ne, qytetarët e Kosovës sot gëzojmë shumë të mira. Po të mos ishin deputetët, nuk mund të themi që nuk do të kishim ligje, por ato do të ishin ndoshta më të pakta në numër. Nga kjo kuptojmë në një farë mënyre se prania e deputetëve në vendin tonë ka rëndësi shumë të madhe. Prandaj, kërkohet nga qytetarët të cilët e gëzojnë të drejtën e votës që kur të votojnë të tregohen shumë vigjilent. Ky është proces shumë i rëndësishëm i vendit.



Edhe gratë janë pjesë e Kuvendit si përfaqësuese tona

Disa nga tiparet që ne si qytetarë kërkojmë nga deputetët ose që ne i vlerësojmë më së shumti janë: të jenë të afërt me popullin, të tregohen të drejtë në situata që nganjëherë janë paksa të vështira për t'u vendosur, të jenë zëri i qytetarëve në çdo kohë, të mos bëjnë dallime në mes qytetarëve, t'i ndihmojnë njerëzve me nevoja të veçanta, etj. Këto ishin po të njëjtat tipare që kërkuam edhe nga edukatorja jonë, kur na pyeti se cilat janë disa nga tiparet që kërkojmë tek një deputet/e. Kurse, tek pyetja se në cilat fusha do të fokusoheshim më shumë nëse ne vetë do të ishim deputetë, ne të gjithë dhamë përgjigje të ndryshme. Disa nga ne mendonin se më e rëndësishme është që të miratohen më shumë ligje që kanë të bëjnë me arsimin, p.sh. të bëhet obligativ edhe shkollimi i mesëm i lartë.

Kjo sepse nëse një vend ka arsim të mirë, atëherë ka edhe ekonomi të mirë. Ka edhe prej atyre që mendojnë se më e rëndësishme është të investohet në shëndetësi. Më së shumti pro kësaj ideje isha unë Dea. Ka shumë arsye që më shtyn të mendoj që shëndetësia është elementi kyç i një shteti. Një prej tyre është se vitin e kaluar kam dëgjuar një rast jo edhe aq të mirë që një të afërme sime iu është dashur të kërkoj shërim jashtë Kosovës. Kur prindërit më treguan arsyen se pse iu është dashur të kërkoj shërim në një vend tjetër, që nga ajo ditë për mua shëndetësia është më e rëndësishme se fushat e tjera. Ajo sipas mendimi tim është më e nevojshme. E për ty i dashur lexues, cila është gjëja më e nevojshme për një shtet të mirë?



Ne si deputetë të ardhshëm do të kemi fokus fusha të ndryshme, por më së shumti ndikimi ynë do të jetë për arsim



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Asdreni“
Klasa: V-3
Vendi: Pejë